



Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Në fillim të muajit shkurt ka vazhduar monitorimi i mësimdhënësve, të cilët janë të përfshirë në programin e trajnimit të MKLSH-së. Monitorimi i mësimdhënësve në qendrat kryesore ka qenë më i lehtë, gjë e cila ka mundësuar mbajtjen e takimit gjysmë-ditor më datën 10 shkurt, ndërsa në disa vende tjera takimi gjysmë-ditor është mbajtur më 23 shkurt. Në këto takime trajnerët kanë bërë analizën e orëve të monitoruara dhe kanë këshilluar mësimdhënësit për mundësitë e ndryshme të realizimit të orës mësimore sipas strukturës ERR. Nga raportet e trajnerëve shihet se mësimdhënësit e përfshirë kanë filluar të zbatojnë teknikat dhe strategjitë e programit të MKLSH-së në klasat e tyre. Në fund të takimeve mësimdhënësit janë njoftuar se seminari i 5 me temën “Të nxënësit në bashkëpunim” do të mbahet më 24-25 mars 2008.

■ Më 3-5 shkurt dhe 26-28 shkurt në lokalet e KEC janë mbajtur 2 seminare në kuadër të MKLSH-së për përfaqësuesit e MASHT dhe disa mësimdhënës të Sh. F. “Zenel Hajdini” në Prishtinë. Seminaret janë zhvilluar në një atmosferë të jashtëzakonshme pune. Pjesëmarrësit kanë qenë shumë të përkushtuar në përvetësimin e njohurive, teknikave dhe strategjive të programit të MKLSH-së. Është me rëndësi të theksohet aktivizimi i të gjithë pjesëmarrësve në realizimin e kërkesave të programit. Pjesëmarrja e një grupi heterogjen të përbërë nga përfaqësues të MASHT, KEC dhe mësimdhënësve i ka kontribuar diskutimeve të cilat janë orientuar jo

vetëm për programin, por dhe për një varg temash interesante që kanë të bëjnë me arsimin në Kosovë në përgjithësi.



Edukimi kundër korrupsionit

■ Më 9 dhe 23-24 shkurt në lokalet e KEC është mbajtur seminari për trajnerë në kuadër të programit “Edukimi kundër korrupsionit”. 19 trajnerëve të certifikuar të programit iu ofruan materiale shtesë, të cilat do të ndihmonin ata në zgjerimin e njohurive për anti-korrupsion. Po ashtu gjatë këtyre ditëve pjesëmarrësit patën rast që në grupe të prezantojnë seanca të caktuara, të cilat kanë shërbyer për të analizuar cilësitë e trajnerëve, si dhe elementet që trajnerët e caktuar duhet të kenë kujdes gjatë punës me të rritur. Pjesëmarrësit e kanë pritur jashtëzakonisht mirë këtë seminar. Disa prej tyre e shprehën qartë kënaqësinë e tyre që morrin pjesë duke shtuar se informacionet që ata kanë marrë nga ky seminar do të ju shërbejnë edhe në prezantimet që ata do të bëjnë në kuadër të programeve tjera. Në njërin nga skedat e daljes shënon

”Grupi i pjesëmarrësve në trajnim ishte një pemë e mrekullueshme e cila

akumulonte dhe induktonte dashuri për një zhvillim të sigurtë profesional dhe jo xheloz, duf dhe inate që shpien në demoralizim dhe shkatërrim. Grupi ishte i lidhur me parimin e litarit dhe me moderim mjeshëtor nga trajnerët ndihmoi në ndërtimin e një manuali edukativ dhe human i cili bazohet në parimet e shenjta njerëzore mbi domosdoshmërinë e luftës së të keqes. Ai na ka ndihmuar të kuptojmë për rëndësinë e punës që duhet të bëjë komuniteti nëse dëshirojmë dhe kemi si qëllim e detyrë përparimin e kombit. Ne duhet të jemi ata që duhet të iu mundësojmë fëmijëve tanë më lehtë të ecin nëpër botë ku do të sundojë drita, e vërteta dhe virtyti, ku liria është kod.”

Hap pas Hapi

■ Gjatë datave 2-4 shkurt u mbajt trajnimi për kasën e tretë për regjionin e Mitrovicës. Ky trajnim është vazhdimësi e trajnimeve të vitit të kaluar të organizuara në bashkëpunim me MASHT. Në trajnim morën pjesë 33 pjesëmarrës. Në fletëvlerësimet e trajnimit, shihet se pjesëmarrësit janë shumë të kënaqur me informatat të cilat i kanë marrë në trajnim.



■ Nga data 23-24 shkurt dhe 1-3 mars u mbajt trajnimi fillestar për klasën

e parë për regjionin e Prizrenit, ku morën pjesë 35 pjesëmarrës.

■ Janë duke vazhduar monitorimet e mësimdhënësve të cilët punojnë me metodologjinë Hap pas hapi. Këto monitorime bëhen me qëllim të ngritjes së cilësisë së punës. Monitorimet u organizuan si në shkollat fillore ashtu edhe në Institucione parashkollore.

Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim

■ Gjatë muajit shkurt filloi cikli i dytë i trajnimeve të 500 mësimdhënësve në kuadër të Projektit “Shoqëria Civile për Pjesëmarrje të Shtuar në Arsim”. Në këtë cikël marrin pjesë mësimdhënës nga shkollat e këtyre rajoneve: Prishtinë, Ferizaj, Pejë, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. Vlen të theksohet se grupi i mësimdhënësve nga Prizreni është i komunitetit boshnjak, për këtë ka ndihmuar shumë, bashkëpunimi që e kemi me organizatën Edukator.



■ Hartimi i politikave që ka filluar në muajin janar është duke vazhduar. Njëra nga politikat ka të bëjë me parandalimin e braktisjes së shkollimit. Lidhur me problemin e braktisjes së shkollës është punuar mjaft shumë nga MASHT si dhe nga sektori i OJQ-ve tjera. Për këtë arsye

në procesin e hartimit të kësaj politike janë ftuar edhe pjesëmarrësit nga MASHT dhe Shoqëria Civile, me qëllim që të ketë gjithëpërfshirje dhe që të shmangen dyfishimet e punës.

Projekti për përmirësimin e pjesëmarrjes në Arsim PPPA II

■ Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim II, po implementohet në tri rajone të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren. Në kuadër të projektit, gjatë muajit shkurt janë organizuar trajnimet me përfaqësuesit e shkollave pjesëmarrëse në ciklin e parë të këtij projekti. Përveç përfaqësuesve të shkollave (anëtarë të këshillave shkollorë), në trajnime ishin të ftuar edhe përfaqësuesit e Drejtorive Komunale të Arsimit nga komunat pjesëmarrëse. Trajnimet u ofruan nga KEC në dy programe trajnimi: Plani Zhvillimor i Shkollës dhe Planifikimi i Projekteve Shkollorë. Këto trajnimeve kanë për qëllim të zhvillojnë kapacitetet planifikuese në nivel shkollor. Shkollat pjesëmarrëse në këtë cikël të projektit, kanë filluar të hartojnë projektet shkollorë. Bashkëpunëtorët profesionalë të Terrenit nga KEC po i ndihmojnë shkollat rreth planifikimit.

Monitorimi i implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim

■ Gjatë muajit shkurt është bërë përzgjedhja e anëtarëve të cilët do të jenë pjesëmarrës në këtë projekt. Aktivitetet kanë filluar të zhvillohen sipas dinamikës së projektit. Muaji shkurt filloi me zhvillimin e trajnimit tregëtor për këta pjesëmarrës.



Trajnimi “Edukimi për të Drejtën Shoqërore” u mirëprit shumë nga këta pjesëmarrës. Ky trajnim i ka dy module. Moduli e dytë i cili po ashtu do të jetë tregëtor, do të mbahet në muajin prill. Tani po bëhen përgatitjet për vazhdimin e aktiviteteve të cilat do të zhvillohen në muajin mars dhe që kanë të bëjnë me planin e monitorimit të kësaj Strategjie.

Access Microscholarship Program

■ Në muajin shkurt, mësimi ka vazhduar sipas planit por vetëm për grupin e Prizrenit. Grupet e Prishtinës kanë pasur një ndërprerje të mësimit për shkak të situatës së zhvilluar në Kosovë. Me nxënësit shqiptarë mësimi po mbahet, por nxënësit e komunitetit serb për shkak të rrethanave ende nuk kanë filluar mësimin. Shpresojmë se në ditët e ardhshme, gjithçka do të jetë në rregull.

Përgatiti: Petrit Tahiri